

Fjalimi i Guvernatorit me rastin e shënimit të 20 vjetorit të BQK-së

Të nderuar,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot të ju dëshiroj mirëseardhje në shënimin e njëzetvjetorit të themelimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ndjej kënaqësi të veçantë që sot në mesin tonë kemi përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare, pa të cilët nuk do të ishte e mundur të arrijmë sukseset që kemi arritur deri më sot. Prandaj, dëshiroj që në emër të të gjithë personelit të BQK dhe në emrin të ju shprehë falënderimet më të përzemërta për gjithë atë çka keni bërë për ne ndër vite dhe për nderin që na keni bërë duke na u bashkëngjitur në shënimin e këtij përvjetori shumë të rëndësishëm për ne.

Për ta kuptuar më mirë situatën ku jemi dhe rrugën nga po ecim, është mirë të kthehemi pak në retrospektivë për të kujtuar se si kemi arritur deri këtu, dhe të kaluarën ta shfrytëzojmë si forcë shtytëse për të ecur edhe më suksesshëm drejtë së ardhmes.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës u themelua në vitin 1999, në një kohë kur Kosova po fillonte së ndërtuari të gjitha institucionet që nga e para. Paralelisht me

krijimin e institucioneve, po fillonte edhe krijimi i bazave të ekonomisë së tregut në vendin tonë.

BQK si një institucion i ri, krahas angazhimeve të mëdha për organizimin e vetë institucionit, ku gjithçka po niste nga e para, filloi të angazhohej për ndërtimin e infrastrukturës financiare, të domosdoshme për krijuar kushtet për fillimin e funksionimit të sistemit financiar në Kosovë. Në këtë mënyrë, BQK-ja shumë shpejtë filloi aktivitetin për ndërtimin e sistemit të pagesave, formulimin e kornizës rregullative për sektorin financiar si dhe zhvillimin e funksioneve tjera të nevojshme për t'i shërbyer ekonomisë së vendit.

Fillimi i funksionimit të BQK-së koincidoi me kohën kur pjesa më e madhe e vendeve të rajonit ishin drejtë përfundimit të procesit të tranzicionit, ku lëshimet e bëra në fillim të këtij procesi, bënë që tranzicioni të jetë i gjatë dhe i vështirë.

BQK tregoi kujdes të lartë dhe mësojë nga vështirësitë nëpër të cilat kaluan bankat e tjera qendrore të vendeve në tranzicion dhe zgjodhi modelin i cili u tregua i suksesshëm për zhvillimin e një sektori financiar efikas dhe të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, BQK vendosi bazat e një sistemi financiar të bazuar në pronësi private dhe që nga fillimi hapi dyert për hyrjen e institucioneve të huaja financiare. Në fakt, ishin institucionet e huaja financiare, veçanërisht bankat, të parat që filluan aktivitetin në Kosovë, duke sjellë përvojat bashkëkohore të industrisë financiare dhe duke rikthyer

besimin e publikut vendor në sistemin financiar. Poashtu, BQK në vazhdimësi ka ndjekur një politikë të shëndoshë të licencimit, e cila ka shërbyer si fundament i zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar të Kosovës.

Sot, pas 20 viteve, ne jemi krenarë me të arriturat e institucionit tonë dhe, për këtë, në radhë të parë dëshiroj të shprehë mirënjohjen për të gjithë punonjësit e BQK-së të cilët me një entuziazëm dhe përkushtim të lartë kanë arritur ta shndërrojnë BQK-në në një institucion modern e të aftë për t'i shërbyer zhvillimit dhe stabilitetit ekonomik të vendit. Gjatë kësaj periudhe, BQK ka shënuar progres të madh në të gjitha shtyllat e aktivitetit të saj, duke arritur të ndërtojë një sistem modern të pagesave dhe duke ofruar shërbime efikase të furnizimit me para të gatshme për ekonominë; kornizë rregullative financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kapacitete të avancuara mbikëqyrëse; statistika cilësore dhe analiza ekonomike e financiare të cilat i ofrojnë autoriteteve vendimmarrëse dhe publikut një kuptim të drejtë të zhvillimeve në ekonominë e vendit; si dhe në vazhdimësi ka treguar efikasitet të lartë në ofrimin e shërbimeve bankare për Qeverinë dhe qytetarët.

Këto të arritura, nuk do të kishin qenë të mundura po të mos ishte ndihma gjithëpërfshirëse dhe e pa kursyer e miqve tanë ndërkombëtar, të cilët me përvojën e tyre dhe dëshirën e madhe për të ndihmuar, bënë që rruga jonë të jetë më e shpejtë dhe më pak e mundimshme. Me këtë rast dëshiroj të shprehë mirënjohje të veçantë

për institucionet ndërkombëtare, siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar, Thesari Amerikan, USAID-i, Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane, GIZ-i dhe shumë institucione tjera që kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin kontribut shumë të rëndësishëm për zhvillimin e institucionit tonë.

Puna jonë e deritanishme, mbi të gjitha, është kurorëzuar me një sistem financiar të shëndoshë, i cili me ritmin e tij të shpejtë të zhvillimit është bërë njëri ndër promotorët kryesorë të zhvillimit dhe stabilitetit të ekonomisë së Kosovës.

Spektori bankar, si komponenti kryesor i sistemit financiar të Kosovës, ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin kredidhënës në ekonominë vendore, duke shërbyer si burim i qëndrueshëm financimi. Depozitat e mbledhura brenda vendit, vazhdojnë të jenë burimi më i rëndësishëm i financimit për bankat dhe rritja e tyre e qëndrueshme ka bërë që aktiviteti kreditues i bankave të ketë nivel të ulët të ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të kushteve të financimit në tregjet e jashtme. Sjellja e kujdesshme e bankave, së bashku me rregullimin dhe mbikëqyrjen e afërt nga BQK-ja si dhe stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik në vend, ka bërë që sistemi bankar i Kosovës të ketë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë kundrejt të gjitha aspekteve të rreziqeve bankare. Me këtë rast, dëshiroj të theksoj normën shumë të ulët të kredive joperformuese prej vetëm 2.2%, që paraqet një cilësi të dëshirueshme të

portofolit kreditor edhe për shumë vende të zhvilluara. Andaj, sot jam i kënaqur që prezantoj një sektor bankar me rritje të qëndrueshme të kredive e të depozitave, me cilësi të mirë të portofolit kreditor, nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozicion të fortë të likuiditetit. Sektori bankar i Kosovës ka shënuar përparim edhe në drejtim të rritjes së efikasitetit të ndërmjetësimit financiar, duke bërë që normat e interesit në kredi të zvogëlohen në masë të theksuar gjatë viteve të fundit.

Progres i ngjashëm është shënuar edhe në komponentët tjerë të sistemit financiar të Kosovës. Sektori i sigurimeve është rritur në vazhdimësi dhe ka treguar aftësi të kënaqshme për të mbuluar obligimet ndaj mbajtësve të policave të sigurimit.

Performancë të kënaqshme ka treguar edhe sektori i pensioneve, ku vlera e kontributeve po vazhdon të rritet, ndërsa menaxhimi i kujdesshëm i mjeteve ka mundësuar që në përgjithësi të rritet vlera e tyre.

Një tjetër segment i rëndësishëm i tregut tonë financiar vazhdojnë të jenë institucionet mikrofinanciare, të cilat në vitet e fundit kanë përshpejtuar ritmin e rritjes së kreditimit, duke rritur kështu edhe rëndësinë e tyre si një burim alternativ i financimit kreditor në ekonominë e Kosovës.

BQK-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në krijimin dhe zhvillimin e institucioneve tjera të rëndësishme për stabilitetin financiar dhe zhvillimin ekonomik

të Kosovës siç janë Fondi për Sigurimin e Depozitave në Kosovë dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.

E gjithë kjo që prezantova deri më tani, konsideroj se paraqet një bazë të mirë për të konstatuar se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka kaluar njëzetë vite të suksesshme, gjatë së cilave ka arritur të shndërrohet në një institucion modern dhe të zhvillojë një sistem financiar të aftë për t'i ndihmuar prosperitetit dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit.

Megjithatë, ne jemi të vetëdijshëm se na presin edhe shumë sfida në të ardhmen – sfida këto me të cilat ballafaqohen edhe bankat e tjera të rajonit dhe më tej. Modelet e bizneseve dhe strategjitë e institucioneve financiare tashmë janë duke ndryshuar më një dinamikë të madhe, gjë që kërkon një dinamikë po aq të madhe për zhvillimin e kapaciteteve rregullative dhe mbikëqyrëse për institucionet financiare. Reformat rregullative duhet të mundësojnë ripërtëritjen apo zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmjetësimit financiar, por në të njëjtën kohë duhet të mundësojnë mbikëqyrje dhe kontroll të mjaftueshëm mbi këto institucione dhe aktivitetet që ato kryejnë.

Sidoqoftë, unë kam besimin e plotë se kapacitetet tona dhe bashkëpunimi jonë i shkëlqyeshëm me bankat tjera qendrore dhe institucionet financiare ndërkombëtare

shërbejnë si garancë e fuqishme se BQK-ja edhe në të ardhmen do të jetë e suksesshme kundrejt sfidave që e presin.

BQK-ja në këtë përvjetor ka ndryshuar edhe logon e saj. Logo e re e BQK-së reflekton vizualisht aktivitetet, vlerat dhe atributet për përfaqësim më të mirë të saj. Elementet vizuale të logos së re t'i japin BQK-së një indentifikim unik. Brenda vetvetes simboli i ri ka kuptimin e rritjes, sigurisë, statistikave dhe parasë. Ngjyrat e logos së re janë ngjyra të cilat i përmban flamuri i Kosovës, flamuri i Bashkimit Evropian si dhe logoja e Bankës Qendrore Evropiane.

Për fund, dëshiroj edhe një herë të ju falënderoj për pjesëmarrjen në shënimin e këtij përvjetori shumë të rëndësishëm për ne dhe uroj diskutime të frytshme me panelistët shumë të nderuar që do t'i kemi gjatë konferencës së sotme, në të cilat do të trajtohen tema shumë të rëndësishme për ekonominë dhe sektorin financiar. Tani kam kënaqësinë të ftoj Shkëlqesinë e tij Presidentin e Kosovës Z. Hashim Thaqi për një fjalë rasti.